

LIGJ
Nr.9260, datë 15.7.2004

PËR DISA SHTESA E NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7748, DATË 29.7.1993 "PËR STATUSIN E ISH-TË DËNUARVE DHE TË PËRNDJEKURVE POLITIKË NGA SISTEMI KOMUNIST", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.7748, datë 29.7.1993 "Për statusin e ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist", i ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Neni 9 ndryshohet si më poshtë:

"Kompensimi financiar i ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë, që kanë marrë pafajësinë sipas ligjit nr.7514, datë 30.9.1991 "Për pafajësinë, amnistinë e ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë", i ndryshuar dhe që gëzojnë statusin sipas ligjit nr.7748, datë 29.7.1993 "Për statusin e ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist", i ndryshuar, ish të dënuarit politikë që përfshihen në kategorinë "A", të cilët kanë humbur jetën apo janë të sëmurë psikikë për shkak të përndjekjes ose trashëgimtarit të radhës së parë sipas Kodit Civil, si dhe ish të dënuarit politikë që përfshihen në kategorinë "B" të parashikuar në nenin 3 të ligjit nr 7748, datë 29.7.1993 "Për statusin e ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist", i ndryshuar, përfitojnë të drejtën e kompensimit financiar në mënyrë të përshkallëzuar mbi bazën e vuajtjes së dënimit si më poshtë:

Periudha e vuajtjes së dënimit	Pagesa mujore në lekë
1 deri në 5 vjet	1 500
5 deri në 10 vjet	2 000
10 deri në 15 vjet	2 500
15 deri në 20 vjet	3 000
20 deri në 30 vjet	3 500
Të pushkatuar	5 000

Neni 2

Pas nenit 21 shtohet neni 21/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 21/1

Për zbatimin e këtij ligji ngrihet një komision i përbërë nga përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale dhe Komitetit të Integritetit të Përndjekurve Politikë.

Organizimi dhe funksionimi i këtij komisioni përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 3

Pas nenit 21/1 shtohet neni 21/2 me këtë përmbajtje:

“Neni 21/2

Kundër vendimeve të Komisionit, të parashikuar në nenin 2 të këtij ligji, mund të bëhet ankim në përputhje me ligjin nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”.”.

Neni 4

Brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 1 dhe 2 të tij.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4296, datë të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu